Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1040

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhani-kryetare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Pro Medical Sh.P.K." kundër Vendimit për anulimin e një aktiviteti të prokurimit të Komunës së Shtimes në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Blerja e paisjeve mjekesore per QKMF-ne" me nr. të prokurimit: "617-23-11005-1-2-1", me 12/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Pro Medical Sh.P.K." me nr. 2023/1040, lidhur me aktivitetin e prokurimit 'Blerja e paisjeve mjekesore per QKMF-ne" me nr. të prokurimit: "617-23-11005-1-2-1" inicuar nga AK - Komuna Shtime.

2. Vërtetohet vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Blerja e paisjeve mjekesore per QKMF-ne" me nr. të prokurimit 617-23-11005-1-2-1 iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna Shtime.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4 dhe 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës,i njejti obligohet brenda 60 dite të parashtrojë kërkesën për kthim pranë OSHP-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 11.10.2023, Komuna Shtime në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Blerja e paisjeve mjekesore per QKMF-ne" me nr. të prokurimit: 617-23-11005-1-2-1. Ndërsa me datën 15.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit, me arsyetimin se mjetet e parapara për këtë aktivitet janë nga grandi qeveritar dhe nuk mund të barten në vitin tjetër, andaj nuk mund të hyn në marrëdhënie kontraktuale pa mjete financiare.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 30,000.00 €.

Me 15.12.2023, OE "Pro Medical Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 18.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Pro Medical Sh.P.K." me nr. 1040/23 lidhur me aktivitetin "Blerja e paisjeve mjekesore per QKMF-ne" me nr. të prokurimit 617-23-11005-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Pro Medical Sh.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon:“Kjo është ankesa e dytë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në herën e parë, AK na ka eliminuar nga ky proces në kundërshtim me Ligjin për Prokurimet Publike (LPP). Pas Ankesës në OSHP, ju lutemi të shikoni Vendimin me numër Prokurimi # 0941, ku ky aktivitet i prokurimit është rikthyer në rivlerësim. Si AK dhe OE jemi pajtuar me raportin e ekspertit në atë kohë, por AK kësaj herë anulon aktivitetin e prokurimit ne kundërshtim me LPP Neni 62 dhe nga neglizhenca e AK, ku ne si OE penalizohemi për veprimet e AK. Neni 1- Qëllimi -E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues ngase i njëjti është ne kundërshtim me nenin 1 te Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin. AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim “Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji” Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ne Pro Medical nuk jemi trajtuar si të barabartë nga AK dhe në kundërshtim me LPP dhe RrPP sepse AK nuk e ka respektuar LPP ku anulimi i këtij aktiviteti te prokurimit bie ndesh me LPP, gjithashtu edhe eliminim jone herën e para ka qene ne kundërshtim me LPP edhe pse kjo është konfirmuar nga OSHP, edhe kësaj here na mohon të drejtën që shpërblemi me kontratë konfrom LPP. 4 / 6 Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit - Pra duke u bazuar në këtë nene AK i lejohet vetëm në dy raste kur AK mundet të anuloj tenderin pas hapjes publike si citim paragrafi 1 “Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. (pra para hapje se ofertave). 1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit (pas hapje së ofertave). Gjithashtu edhe Neni 43 Rregullorja për prokurimin publik 2022 nuk është respektuar nga AK. Pra AK duke neglizhuar këtë aktivitet të prokurimi, ka anuluar me arsyetim si me poshtë. “Ju njoftojmë se kemi anuluar aktivitetin e prokurimit për Blerjen e paisjeve mjekesore per QKMF-ne, për arsyje se jemi ne fund te vitit fiskal, dhe është e pa mundur arritja e afateve kohore për nënshkrim te kontratës dhe realizimin e saj këtë vit. Mjetet e parapara për këtë projekt janë nga grandi qeveritar, dhe nuk barten ne vitin tjetër, kështu qe ne si AK nuk mund te hymë ne marrëdhënie kontraktuale pa pasur mjete financiare.” AK ka marr Vendim për anulimin e aktivitetit te prokurimit me arsyetim të pa bazuar në LPP Neni 62 pasi që një që tillë nuk është e rregulluar me LPP në fuqi dhe një arsyetim i tillë AK bie ndesh me LPP Neni 62 edhe njeherit AK duke përdorur këtë praktike ne një mënyrë bie deri ne abuzim me LPP, ku rrjedhimisht AK nuk do respektuar edhe Neni 7. Pasi që neni 62 i LPP mjaftë qartë precizon se në cilat raste mund të përfundoj aktiviteti i prokurimit, po ashtu edhe në nenin 43 të RRPP 001/2022 përcaktohen rastet se kur mund të bëhet ndërprerja e procedurës së prokurimit, ndërsa, arsyeshmëria e AK për ndërprerje të kësaj procedure nuk parashihet në këtë dispozitë. Sepse AK është i obliguar të që konform dispozitave ligjore ta bëjë ligjshmërinë e secilit veprim. Andaj AK duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur bazë ligjore pra në kundërshtim me LPP sidomos Neni 62 dhe AK duke mos marr asnjë mundim që të përfundoj këtë aktivitet të prokurimit konfrom LPP dhe arsyetimi i cekur në njoftimi e AK me datën 15.12.2023 për anulim me është një arsyetim jo valid dhe pa bazë ligjore. Me rastin e

anulimit te aktivitetet të prokurimit AK nuk ka respektuar asnjë nga depozitat e nenit 62 te LPP-së, madje edhe ne interpretimin KRPP- është sqaruar se ne cilat rrethana AK mund te anuloj aktivitetin e prokurimit. Gjithashtu edhe RrPP Pika 43. Ndërprerja e procedurave të prokurimit - Pra shumë qartë RrPP pikat e cekur ne paragrafin 43.5 shpreh se kur mund AK te anuloj një aktivitet të prokurimit pra arsyetimi AK në këtë rast pra në vendimin tuaj bie ndesh edhe LPP edhe me RrPP Pika 43.5 kurse Rregulloren për prokurimin publik 2022 qartë e specifikon kur një tender mund te anulohet pas hapjes. 5 / 6 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opsionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP. 43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK." Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Pro Medical Sh.P.K." konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 62 të LPP-së duke kërkuar nga OSHP që të aprovoj ankesa si të bazuar, të anuloj Vendimin e AK dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, në përgjigje ndaj kërkesën për rishqyrtim ka pohuar shkurtimisht :"Ju njoftojmë se kemi anuluar aktivitetin e prokurimit për Blerjen e pajisjeve mjekësore për QKMF-në, për arsyeje se jemi në fund të vitit fiskal, dhe është e pa mundur arritja e afateve kohore për nënshkrim të kontratës dhe realizimin e saj këtë vit. Mjetet e përpara për këtë projekt janë nga grandi qeveritar, dhe nuk barten në vitin tjetër, kështu që ne si AK nuk mund të hymë në marrëdhënie kontraktuale pa pasur mjete financiare."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1040/23, ndërsa me datë 07.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1040 me rekomandimet si në vijim:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti është i mendimit që nëse Autoriteti konsideron dhe insiston që këto mjete janë tërhekur atëherë le të mbetet në diskrecionin e Panelit Shqyrtues të vendos për anulimin ose jo të këtij aktiviteti.

Lidhur me pretendimet e OE "Pro Medical Sh.P.K." - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1040 ka vlerësuar si në vijim:

“Sipas shpjegimeve te paraqitura konstatojmë qe kjo ankese e përsëritur është gjykuar njëherë me vendimin e marre nga PSH te cilët konstatojnë se përfundon kjo procedure ankimore ngase te gjitha palët janë pajtuar me gjetjet e ekspertit si dhe lënda është kthyer ne rivlerësim. Por pas kësaj AK ka dërguar një njoftim ku shpjegon se ka anuluar procedurën mbi arsyetimin se:" Ju njoftojmë se kemi anuluar aktivitetin e prokurimit për Blerjen e pajisjeve mjekësore për QKME-ne, për asye se jemi ne fund te vitit fiskal, the është e pa mundur arritja e afateve kohore për nënshkrim te kontratës dhe realizimin e saj këtë vit. Mjetet e parapara për këtë projekt janë nga grandi qeveritar, dhe nuk barten ne vitin tjetër, kështu që ne si AK nuk mund te hyn ne marrëdhënie kontraktuale pa pasur mjete financiare." me këtë rast duke mos respektuar paragrafin ne vendimin PSH i cili thotë qe: Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se ne kuptim te nenit 19, paragrafi 4, te Rregullores për punën e OSHP parashihet se, cituar: "Ne rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerre njoftim qe autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditsh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedure. Për më tepër informohen palët, qe ky vendim ka karakter procedural për palët ne procedure dhe ne rrethana te tilla te gjeturat e këtij raporti nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Paneli Shqyrtues. Në bazë të kësaj përgjigje dhe sqarimi te dhënë nga AK, eksperti ka dërguar kërkesë me shkrim nëpërmjet emalit drejtuar AK Komuna Shtime me ç’rast ka kërkuar nga ta te dërgojnë Buxhetin e planifikuar për vitin 2024 ku edhe ka marrë të bashkëngjitur këtë dokument në të cilin shihet që në tabelën me kodin 53578 figuron pozicioni në vlerë prej 30,000.00 me titull: "Blerja e Pajisjeve mjekësore për QKMF-ne". Pas kësaj eksperti edhe njëherë ka kërkuar përmes emailit qe autoriteti kontraktues ta ri konfirmojë se ekziston disponueshmeria e këtyre mjeteve për shfrytëzim për këtë projekt ne vitin 2024. Përgjigja e autoritet ishte sinë vijim: Ne si AK, dhe dërguar buxhetin 2023-2024 për aktivitetin e lartcekur, nuk ka mjete të planifikuar dhe për këtë arsye nuk kemi vazhdu procedura dhe nënshkruar kontrata.Ne anën tjetër, ne tabelat e dërguara edhe pse janë te pakjarta për shkak te skanimit eksperti nuk ka mund te verifikoje nëse kjo përgjigje është e sakte ne baze te dokumentacionit te ofruar ngase ne tabelën e dërguar për vitin 2023 nuk ka shënime që tregojnë që ajo tabele është e atij viti, andaj eksperti është i mendimit që nëse Autoriteti konsideron dhe insiston qe këto mjete janë tërhequr atëherë le te mbetet ne diskrecionin e Panelit Shqyrtues te vendos për anulimin ose jo te këtij aktiviteti.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit duke theksuar “ne kërkojmë nga OSHP te aprovoj kërkesën tone dhe nuk pajtohemi qe mendimin e eksperti ku nuk ka thënë rekomandim pozitive lidhur me Ankesën tone. Andaj AK duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur bazë ligjore pra në kundërshtim me LPP sidomos Neni 62 dhe AK duke mos marr asnjë mundim që të përfundoj këtë aktivitet të prokurimit konfrom LPP dhe arsyetimi i cekur në njoftimi e AK me datën 15.12.2023 për anulim me është një arsyetim jo valid dhe pa bazë ligjore pra AK ka neglizhuar këtë aktivitet te prokurimit dhe ne ka diskriminuar neve si OE edhe pse këtë aktivitet te prokurimit janë dorëzuar dy ankesa ne OSHP se me nr. prokurimit 2023/0941.”

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, bazuar në faktet e radhitura si më sipër nga ana e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar ato në kontekstin e përgjithshëm të legjislacionit, kompetencave të një autoritetit kontraktues dhe qëllimit të tij/saj të manifestuar përmes një aktiviteti konkret të prokurimit publik, Paneli konsideron se raporti i ekspertit karakterizohet nga një punë profesionale dhe hulumtuese, sepse kthimi i këtij aktiviteti në rivlerësim, tejkalon parimet bazë të legjislacionit së paku për arsyet si në vijim: Në kuptim të nenit 4 [paragrafi 1.13 dhe 1.44] autoriteti kontraktues d.t.th. një autoritet publik, në cilin do nivel [qendror dhe/ose lokal] fushëveprimi dhe kompetencat e të cilëve rregullohen me legjislacion specifik, pa nevojë për shpjegim më konkret. Kurse, sipas paragrafit 1.42, të dispozitës së cituar, një aktivitet i prokurimit, shpreh dhe/ose publikon qëllimin e një AK drejt dhënies së një kontrate publike, sikurse përkufizohet ajo, sërish me dispozitën e cituar me paragrafët 1.45 dhe 1.46.

Nga pikëpamja e ekspertit shqyrtues dhe këtij Paneli njëkohësisht, veprimet si më sipër të përshkruara nga ana e ankuesit dhe gjetjeve të ekspertit shqyrtues manifestojnë qasje jo serioze nga ana e AK, respektivisht të kësaj Komune, sa i përket inicimit të këtij aktiviteti e pastaj anulimi i tij nga AK së paku për arsyet se:

1. Me 11/10/2023, bazuar në autorizimet dhe aktet e cituara si më sipër, Komuna e Shtimes e kishte publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit, i përshkruar si më sipër.
2. Me 16/11/2023, Komuna e Shtimes e kishte rekomanduar për kontratë një OE, kundër të cilit vendim, ankuesi ishte drejtuar me datën 24.11.2023 me ankesë në OSHP,
3. Me 11/12/2023, ishte publikuar raporti i ekspertizës nga Eksperti shqyrtues Nr. 2023/0941, për të cilin ishin pajtuar te dyja palët OE dhe AK, kurse me 13.12.2023, OSHP kishe publikuar vendimin procedural për pajtim të palëve.
4. Me 15/12/2023, Komisioni i Rivlerësimit kishte publikuar raportin duke cituar: "Komisioni i ri-vlerësimit rekomandon për anulimin e tërësishëm të këtij aktiviteti pasi që tani jemi në përmbyllje të vitit fiskal dhe nuk mundet që ky projekt të përfundoj brenda afateve kohore të vitit fiskal".
5. Me 15/12/2023, AK bënë anulimin e tërësishëm të këtij aktiviteti bazuar në raportin e komisionit të rivlerësimit.
6. Duke u bazuar në përshkrimin e procedurës dhe arsyeve të anulimit, eksperti sipas raportit të dytë nr. protokolli 2023/1040 iniciuar sipas ankesës së dytë në OSHP të datës 22.12.2023, ka shpjeguar se aktiviteti i prokurimit numër 617-23-11005-1-2-1 me titull "Blerja e pajisjeve mjekësore për QKMF-në" i iniciuar nga komuna e Shtimes nga cilësia e saj ai AK, me qëllim të vlerësimit të drejtë ka njoftuar se dy herë kishte dërguar kërkesë me shkrim tek AK, me ç'rast kishte kërkuar nga ta te dërgojnë Buxhetin e planifikuar për vitin 2024, kurse lidhur me përgjigjën e tij, ka pranuar njoftimin cituar "..Ne si AK, ju kemi dërguar buxhetin për vitin 2023-2024, kurse për aktivitetin e lartcekur ju njoftojmë se nuk ka mjete të planifikuar për këtë aktivitet dhe për këtë arsye nuk kemi pasur mundësi për të vazhduar me procedurën e prokurimit dhe për të nënshkruar kontratën.

Në ketë rast, bazuar në faktet e radhitura si më sipër, sqarimeve të ekspertit shqyrtues dhe sqarimeve të autoritet kontraktues dhe pas verifikimit të bërë në buxhetin e miratuar për vitin 2024 nga Asambleja Komunale, konstatohet se AK nuk ka mjete të destinuara për këtë furnizim/aktivitet dhe po ashtu nuk ka buxhet të aprovuar as nga grandi qeveritar. Andaj Paneli konsideron se anulimi i aktit të atakuar dhe kthimi i këtij aktiviteti në rivlerësim bije ndesh me kërkesat dhe parimet e sanksionuara me dispozitat e Kapitullit III, të LPP, posaçërisht me nenet 8 dhe 9 [planifikimi i prokurimit dhe i nevojave të një autoritetit kontraktues] e deri tek Kreu V, i këtij Ligji, nga neni 22 [Inicimi i prokurimit] e deri tek neni 26 [Nënshkrimi i kontratave publike].

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në RREGULLORE Nr.001/2022 neni 8.5 nder te tjera thotë: Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që para publikimit të Formularit "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar. Tek Disponueshmeria e mjeteve Neni 3: Shqyrtimi, nder te tjera shënon: Kjo "Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve" duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim te kontratave para publikimit te Njoftimit për dhënie te kontratës me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht. Në ketë rast pas shqyrtimit nga personat e autorizuar para publikimit te njoftimit për dhënie te kontratës, zyra e prokurimit ka pranuar shkresën ku saktëson se ka ndryshim te mjeteve buxhetore se ky projekt nuk mund te realizohet për arsyet e cekura më lartë. Kështu që, si pasojë e gjendjes së krijuar, përgjegjësin e mban vetë autoriteti kontraktues edhe sa i përket përmbajtjes së të gjitha shkresave,

Bazuar në Rregullën Financiare NR.01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike neni 13 Menaxhimi i projekteve kapitale "Projektet kapitale menaxhohen me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ligji për ndarjet buxhetore përmban vlerësimet se sa do të shpenzohen në secilin projekt dhe në secilin vit. SIMFK përmban kufizime ashtu që fondet e alokuara në kategorinë ekonomike të "kapitalit" mund të zotohen vetëm për projekte të tilla. Nëse një projekt kapital duhet të realizohet në vitin e tanishëm, dhe është vonuar, atëherë fondet mund të zotohen në një vit në të ardhmen për ta përfunduar projektin kapital vetëm nëse kjo pasqyrohet në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, nga ndarjet buxhetore të vitit të ardhshëm të BRK".

Mirëpo, është po ashtu jo kontestuese se AK gjatë këtij aktiviteti ka vepruar në kundërshtim me parimet bazë të LPP-së, së paku për shkaqet e radhitura në pikat 1,2,3,4,5, dhe 6 nga kuadri Gjetjet e Panelit Shqyrtues. Dhe për ketë shkak Paneli Shqyrtues konsideron se zyrtari përgjegjës i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP neni 8 [Planifikimi i Prokurimit] neni 24.2 [Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit], po ashtu ka vepruar në kundërshtim me RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK respektivisht nenin 96.1 [pika e] andaj ndaj të njëjtit, nëse në të ardhmen vërehen të tilla veprime jo-serioze sikurse janë precizuar ato më sipër do të kërkohet të merren masat përkatëse pranë KRPP-së.

Njëherësh bazuar mbi faktet dhe rrethanat e shpjeguara si më sipër obligohet AK-Komuna e Shtimës, që kompensoj ankuesit shpenzimet e procedurës në pajtim me Rregulloren e punës së OSHP-së e cila i nënshtrohet miratimit konform nenit 107 të LPP-së. Prandaj bazuar në shpjegimet si më sipër Paneli Shqyrtues konsideron se raporti i ekspertit ka ndikuar me të drejtë në krijimin e gjykimit të pavarur duke vendosur në ketë rast, ashtu sikurse kërkohet në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me kompetencat e parapara shprehimisht me dispozitën e nen it 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, 105 dhe 117 të LPP

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marr në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Për pikën 1 dhe 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën 3 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Prandaj nisur nga të lartcekurat është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA SHTIME**
- OE - **PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: